**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTETREVE TIRANE**
**NR** 1644 **REP.**
**NR** 96 **KOL.**

**KONTRATE SHITBLERJE**
**KUOTASH TE KAPITALIT TE**
**SHOQERISE "KLOMER"**

Sot me date 23.04.2005(dymije e pese)ne Tirane para meje noteres Rajmonda Dyrmishi ,me seli ne Rrugen"M. Shyri",pll.49 u paraqiten personalisht per nje kontrate shitblerje kuotash ne baze te nenit 705 e vijues te K. Civil dhe Ligjit Tregtar , palet :

**PALA SHITESE :**

**1.Neshet Shaqir Zemlaku,**lindur me 1943 ne Lushnje ,banues ne Tirane,Rr. " Bajram Curri", nr.14madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar ,identifikuar me pasaporte. 01115964.

**2.Lamçe Shahin Begaj,**lindur me 10.12.1953 ne juridike per te vepruar, identifikuar me pasaporte nr.Z0038907.

**PALA BLERESE :**

**1.Pajtim Nazif Merkaj,** lindur ne Lushnje ,banues ne Tirane , madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar,identifikuar me pashaporte nr. 1440026.

Ne mbeshtetje te Vendimit Nr.8958 date 16.02.1995 te Gjykates se rrethit Tirane ,akt themelimit dhe statutit te Shoqerise "KLOMER"shpk Z. Neshat Zemlaku zoteron 30% te kuotave , Lamçe Begaj zoterone 30 % (tridhjete perqind) te kuotave dhe z,Pajtim Merkaj 40% te kuotave ne Kapitalin Themeltar ne shoqerine "KLOMER" sh.p.k.Pala shitese Neshat Zemlaku dhe Lamce Begaj ne mbeshtetje dhe Vendimit nr.1 date 21.04.2005 te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "KLOMER" shpk bie dakort qe te shesin sejcili kuotat e tyre te kapitalit qe zoterojne ne kete shoqeri , ne masen 60% gjithesej te kuotave me cmimin ne vleften totale 60000(gjashtedhjetemije)leke, ne favor te pales blerese Pajtim Merkaj ,duke u larguar dhe nga veprimtaria dhe cdo detyrim i shoqerise.

Pala shitese garanton palen blerese se shitja e kuotave te kapitalit te shoqerise behet pa asnje kusht apo barre per palen blerese duke u likujduar per detyrimet reciproke jashte kesaj zyre dhe pala blerese Pajtim Merkaj pranon te bleje kuotat e kapitalit ne pjeset e percaktuara me larte dhe cmimin e shitjes .

Me nenshkrimin e kesaj kontrate dhe noterizimin e saj pala shitese zhvishet nga pronesia mbi pjeset e kuotave te kapitalit qe zoterojne dhe pala blerese behet zoteruese 100% te kuotave te kapitalit te Shoqerise "KLOMER" shpk .Persa nuk eshte shprehur ne kete kontrate i referohet rregullimit nepermjet dizpozitave te K.Civil ne fuqi,Ligjit nr.7638 date 19.11.1992"Per Shoqerite tregtare' dhe Ligjit Nr.7667 date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar".

Gjate perpilimit te kesaj kontrate u administruan aktet perkatese te shoqerise, vendimi e Gjykates se Shkalles se pare Tirane per shoqerine .

Kontrata u hartua ne perputhje me vullnetin e lire te paleve ne njohur prej paleve dhe nga une notaria te cilet pasi e lexuan , nuk kane verejtje dhe nenshkruajne rregullisht para meje noteres.

Une noteria e vertetoj aktin ne baze te ligjit.

PALET

SHITESIT

1

2

BLERESI

1

NOTERE

PULLE TAKSE

100 LEKE

R.SHQIPERISE